

ELTERNINFORMATION ÜBERGABEBLATT **Albanisch**

Të nderuar prindër,
të nderuar persona me të drejtë edukimi,

bashkëngjitur do të gjeni **letrën e dorëzimit** në të cilën jepet në përfundim të periudhës së kopshtit të fëmijëve një **informacion mbi gjendjen gjuhësore aktuale të fëmijës Suaj**.

Hyrja në shkollën fillore paraqet për çdo fëmijë dhe familje një eveniment të një rëndësie të veçantë. Prandaj kopshti i fëmijëve dhe shkolla fillore përpiqen të përkrahin dhe të shoqërojnë çdo fëmijë në fazën e kalimit – veçanërisht në zgjerimin e aftësive të tij gjuhësore.

Me synimin që për fëmijën Tuaj të ofrohet qysh nga fillimi mbështetja e duhur, e cila do t'i nevojitet atij për të përballuar në mënyrë pozitive sfidat e arsimit shkollor, dhe për të vazhduar përkrahjen gjuhësore sipas mundësisë pa asnjë ndërprerje, përgjegjësve të shkollës fillore u nevojiten informacione mbi gjendjen gjuhësore aktuale të fëmijës Suaj.

Prandaj, **për të mundësuar mbështetjen më të mirë të mundshme të fëmijës suaj**, sipas ligjit për detyrimin shkollor, ju si prindër jeni **të detyruar që ta paraqisni** me besnikëri këtë fletë **në shkollën e ardhshme fillore të fëmijës tuaj**. Lutemi ta paraqisni këtë model sa më shpejt të jetë e mundur.

Me urimet më të mira
Ekipi Juaj i kopshtit të fëmijëve